



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3452/1 Prot.

Tiranë, më 25/09 /2026

Lënda:

Ripërsëritje e kërkesës për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 62/2026.

Drejtuar:

Z. Niko PELESHI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Në vijim të shkresës sonë nr. 3452 Prot., datë 27.07.2026, me anë të së cilës kemi kërkuar ndjekjen e procedurave parlamentare për zbatimin e vendimit nr. 62/2026 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, jemi të detyruar t'ju rikërkojmë përsëri që ju të përmbushni detyrimet tuaja kushtetuese. Prej më shumë se 2 muajsh, ju në cilësinë e autoritetit përgjegjës për nisjen e procedurës parlamentare për zbatimin e këtij vendimi detyruar të Gjykatës Kushtetuese, jeni duke shkelur nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, datë **22.07.2026** dhe ka hyrë në fuqi atë ditë. Për këtë arsye, duhet të ishte marrë në shqyrtim sipas nenit 87 të Rregullores së Kuvendit brenda 30 ditëve nga Këshilli i Legjislacionit, që mbledhet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit. Mosveprimi juaj antikushtetues po cenon rëndë të drejtat e pakicës parlamentare dhe shtetin e së drejtës. Refuzimi apo vonesa në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është e papranueshme për opozitën dhe provon degradimin institucional të Kuvendit të Shqipërisë.

Përsa më lart, kërkojmë të merrni masa menjëherë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të përmbushni detyrimet tuaja sic ju është bërë me dije në shkresën nr. 3452 Prot, datë 27.07.2026 të Grupit Parlamentar të PD.

Gazment BARDHI

KRYETARI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 3452 Prot.

Tiranë, më 27 / 07 /2026

Lënda: Kërkesë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 62/2026.

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

I nderuar Z. Kryetar,

Sipas nenit 132 të Kushtetutës vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Përmes vendimit nr. 62/2026, datë 01.06.2026 Gjykata Kushtetuese ka vendosur:

“Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025”.

Shfuqizimin e vendimit nr. 78/2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025””, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim është shpallur i arsyetuar më datë 17.07.2026 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, datë 22.07.2026. Për pasojë, sipas pikës 2, të nenit 132 të Kushtetutës vendimi ka hyr në fuqi më datë **22.07.2026** dhe duke nisur nga ajo datë është i detyrueshëm për zbatim.

Edhe pse ka kaluar 1 javë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese rezulton se Kryetari i Kuvendit ende nuk ka përmbushur përgjegjësitë e tij kushtetuese për nisjen e procedurës parlamentare për zbatimin e këtij vendimi.

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës dhe neneve 14 dhe 87 të Rregullores së Kuvendit,

KËRKOJMË:

- Dërgimin menjëherë të këtij vendimi pranë Këshillit të Legjislacionit dhe thirrjen e mbledhjes së tij, brenda këtij sesiioni parlamentar, duke përcaktuar rendin e ditës sipas pikës 6, të nenit 14 të Rregullores së Kuvendit.
- Përfshirjen më pas në rendin e ditës së seancës plenare me të afërt për miratim projektvendimin “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Gazment BARDHI



KRYETAR

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE